

---

## AKT THEMELIMI "A&D WOOD" SHPK

### 1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.

Emri i shoqërisë do të jetë **"A&D WOOD" SHPK**, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

### 2. Ortakët e shoqërisë janë:


1. Dritan Shehu, shtetas Shqiptar, atesia Hysen, i datëlindjes 25.05.1981 lindur në Kruje, dhe banues në Tirane, mbajtes i leternjotimit me numër identifikimi ID 034999982 dhe numër personal I10525081G.
2. Albano Shehu, shtetas Shqiptar, atesia Hysen, i datëlindjes 17.05.1973 lindur në Kruje dhe banues në Tirane, mbajtes i pasaportes me numër BC7316411 dhe numër personal H30517051P.

### 3. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Prodhim dhe shitje të mobiljeve me shumice dhe pakice, elementeve të drurit, import dhe eksport etj. Riparim mobiljesh, lysterje mobiljesh, dhenie mobilje me qera. Eksport - Import të cdo makinerie apo pajisje që ka lidhje me prodhimin, si dhe cdo materiali tjetër të nevojshëm që lidhet me këto aktivitetet e lartë përmendura. Shfrytëzim, Prodhim, Perpunim, Tregtim dhe Transport i lëndës drusore, të paperpunuar dhe të perpunuar, si, ah, lis, pishe etj si dhe druve të zjarrit. Ndertim objekte banimi, rrugë, punime. ndertimi të ndryshme. Tregtim prodhimesh të ndryshme, druri, mobilje, orendi etj.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.



---

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

#### **4. Selia e shoqërisë.**

5.1. Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën **Rruga "Tufine", Zona Kadastrale 3426, Nr. pasurie 3/4,**

- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

#### **5. Kohëzgjatja e shoqërisë.**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).


#### **6. Kapitali themeltar.**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë) lekë**.
- Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota .
- Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:
- Dritan Shehu është zotërues i 1 (nje) kuote, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.
- Albano Shehu është zotërues i 1 (nje) kuote, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.

#### **7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.



- 
- Administratori.

## **8. Administratori.**

- Administratori Kryesor i shoqërisë emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar.
- Administratori i Dytë (me kompetenca të kufizuara) emërohet për një mandat 3 (tre) vjeçar.
- Administratorët emërohen ose shkarkohen nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator e shoqërisë është:
- Dritan Shehu, shtetas Shqiptar, atesia Hysen, i datëlindjes 25.05.1981 lindur në Kruje, dhe banues në Tirane, mbajtes i leternjotimit me numër identifikimi ID 034999982 dhe numër personal I10525081G.
- Kompetencat e administratorëve përcaktohen më në detaje në statutin e shoqërisë.

## **9. Likuidimi i shoqërisë.**


Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

## **ORTAKËT E SHOQËRISË**

**Dritan Shehu**



**Albano Shehu**



**Datë 02.05.2024**

